



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Investment Corporate Lawyers" të datës 22.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Investment Corporate Lawyers" të datës 22.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" (tutje "parashtruesi") me datë 22.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. të prokurimit 616-25-8826-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1. – “Kriteri 1 (arbitrazhi): “OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy (2) shërbime të ngjashme të arbitrazhit vendor ose ndërkombëtar, si dhe dy (2) shërbime të procedurave gjyqësore në 3 (tri) vitet e fundit...”. Kriteri 2 (forma & mosha): “Të jetë Shoqëri e Avokatëve konform nenit 27 par.1 nënpar.1.3 dhe nenit 30 të Ligjit nr. 04/L193 për Avokatinë për së paku 7 (shtatë) vite, me së paku 5 avokatë të licencuar nga OAK; të paktën njëri me përvojë mbi 10 vite pas licencimit.”. Kërkesë korrektuese për Kriterin 1: të zëvendësohet me: “Tre (3) përfaqësime të suksesshme në konteste komplekse të së drejtës publike administrative civile komerciale që përfshijnë autoritete publike ose ndërmarrje publike apo Shoqerore në 3 vitet e fundit, në gjykata ose arbitrazh (pranohen të dyja forumet), të dëshmuara me kontrata/aktmarrëveshje, konfirmime të klientit ose akte gjyqësore përfundimtare.” Kjo e bën kriterin të lidhur me lëndën e kontratës dhe jodiskriminues.

P.2. – “Kërkesë korrektuese për Kriterin 2: Të hiqet kushti “të jetë shoqëri e avokatëve për së paku 7 vite” dhe të zëvendësohet me: “Ekip minimal prej 5 avokatësh të licencuar (qoftë nga një shoqëri, zyrë e përbashkët, zyrë individuale apo konsorcium), ku të paktën njëri ka 10 vite përvojë licencimit; pranohen kapacitetet e palëve të treta me angazhime të detajuara.”

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Sipas përgjigjeve të ofruara nga njësia kërkuese, kërkesat e DT për të cilat parashtruesi ka prezantuar pretendimet ankimore, janë kërkesa absolutisht të domosdoshme për të garantuar cilësinë, efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve për të cilat ka tenderuar AK. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë provë të matshme apo ligjshme apo ndonjë argument të ligjshëm për të mbështetur pretendimet e tij ankimore.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.11.2025



Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.